

Trajtimi i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, me ndikim social në Kosovë

Mars, 2025





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdorë citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org
Autor: Vullnet Bugaoku
Dizajni: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit *“Citizen Engagement for Public Integrity (CEPI) in the Western Balkans and Turkey”* – që implementohet në bashkëpunim me Transparency International e.V. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.



TABELA E PËRMBAJTJES

07

HYRJE

09

ZVARRITJET DHE
PARASHKRIMI
I RASTEVE TË
KORRUPSIONIT NË
KOSOVË

13

MANGËSITË E AKTAKUZAVE
– FAKTORI KRITIK NË
DËSHTIMIN E NDJEKJES SË
RASTEVE TË KORRUPSIONIT

17

POLITIKA E BUTË
NDËSHKIMORE DHE
MOS-EFIKASITETI NË
KONFISKIMIN PENAL TË
PASURISË NË RASTET E
KORRUPSIONIT

21

TRAJTIMI INSTITUCIONAL
I RASTEVE TË
KORRUPSIONIT GJATË
VITIT 2024

25

PËRFUNDIME

1





HYRJJE

Lufta kundër korrupsionit mbetet një nga sfidat më të mëdha për sistemin e drejtësisë në Kosovë. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme dhe reformave ligjore, rastet e korrupsionit të nivelit të lartë vazhdojnë të përballen me vonesa procedurale, aktakuza të dobëta dhe një politikë të butë ndëshkimore, duke krijuar një perceptim të gjerë të mosndëshkueshmërisë institucionale.

Ky punim ofron një pasqyrë më të detajuar mbi trajtim institucional të rasteve të korrupsionit në Kosovë, duke përfshirë hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e tyre nga prokuroria dhe gjykatat. Në qendër të studimit janë 30 rastet më të rëndësishme të korrupsionit, të cilat përfshijnë figura të larta publike dhe institucione kyçe në vend.

Rastet më të spikatura të analizuara përfshijnë Pronto, Hidrocentralet, Stenta 1, Toka, Vizat, Veteranët, Thesari, Subvencionet, Rezervat Shtetërore, si dhe raste të profilit të lartë si ai i Nagip Krasniqit dhe ministres Donika Gërvalla. Këto raste kanë nxjerrë në pah dështimet sistemike në ndjekjen e korrupsionit, si dhe sfidat institucionale që e bëjnë të vështirë ndëshkimin e tij në praktikë.

Përmes analizës së këtyre rasteve, që janë pjesë e një databaze të rasteve të korrupsionit në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë – që është në zhvillim e sipër nga Transparency International – janë identifikuar tre sfida kryesore që minojnë efektivitetin e sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit:

-  **Zvarritja e proceseve gjyqësore dhe parashkrimi i lëndëve;**
-  **Cilësia e dobët e aktakuzave;**
-  **Politika e butë ndëshkimore dhe mungesa e konfiskimit penal të pasurisë**





ZVARRITJET DHE PARASHKRIMI I RASTEVE TË KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Në Kosovë, gjykimi i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë vazhdon të karakterizohet nga zvarritje të gjata dhe një sërë parregullsish, të cilat shpesh sjellin si pasojë parashkrimin e lëndëve dhe lirim nga akuza të zyrtarëve të lartë, të cilët akuzohen për korrupsion dhe dëmtim të buxhetit të shtetit. Mungesa e efikasitetit të sistemit të drejtësisë, vonesat procedurale, si dhe aktakuzat e cilësisë së dobët, ndikojnë drejtpërdrejt në këtë fenomen, duke e bërë ndëshkueshmërinë e korrupsionit pothuajse inekzistente në praktikë.

Rasti “Hidrocentralet” – Dështimi klasik i sistemit

Një nga shembujt më eklatantë të zvarritjes dhe pasojave të saj është rasti “Hidrocentralet”, ku disa ish-ministra të Qeverisë Thaçi 2 – përfshirë Besim Beqajn, Mimoza Kusari-Lilën, Dardan Gashin dhe Nenad Rashiqin – akuzoheshin për keqpërdorime në procesin e privatizimit të disa hidrocentraleve.

Vepra penale dyshohej se është kryer më 8 maj 2013,¹ dhe sipas legjislacionit penal në fuqi, parashkrimi absolut i ndjekjes ndodh kur kalojnë më shumë se 10 vite nga momenti i kryerjes së veprës.²

Në këtë rast, afati i parashkrimit u përmbush më 8 maj 2023, duke bërë që procesi të përfundojë pa asnjë ndëshkim penal, ndonëse të akuzuarit ishin liruar nga aktakuza, pak kohë para parashkrimit.

Një aspekt tjetër që e nxjerr në pah joefikasitetin e sistemit gjyqësor është fakti se 866 ditë pas shpalljes së pafajësisë nga shkalla e parë, Gjykata e Apelit e konfirmoi këtë vendim në mars 2023, vetëm pak muaj para se të ndodhte parashkrimi absolut. Ky ritëm i ngadaltë i procesit gjyqësor tregon për dështimet sistemike në përmbylljen e rasteve brenda afateve ligjore.

1 Portali Kallxo.Com, 13 mars 2023, <https://kallxo.com/lajm/rasti-hidrocentralet-gjyqi-ndaj-ish-ministrave-te-qeverise-thaci-2-drejt-parashkrimit-absolut/> (Qasur më 27 nëntor, 2024).

2 Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 99.



Rasti “Stenta 1” – Një tjetër rast pranë parashkrimit

Një tjetër shembull ku sistemi gjyqësor ka rrezikuar të çojë në parashkrim një rast të madh korrupsioni është rasti “Stenta 1”, i cili përfshinte ish-ministrin e Shëndetësisë Ferid Agani dhe sekretarin e përgjithshëm të kësaj ministrie, Gani Shabani. Ata akuzoheshin për shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik, duke lejuar kundërligjshëm pagesa për trajtimin e pacientëve në spitale private gjatë periudhës 2011-2015.³

Për këtë rast, më 15 qershor 2016, Prokuroria e Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër Aganit, Shabanit dhe 62 personave të tjerë, të cilët akuzoheshin për keqpërdorim të pozitës zyrtare, marrje dhe dhënie ryshfeti, si dhe disa vepra të tjera penale. Për shkak të kompleksitetit të rastit, më 26 shkurt 2018, aktakuza u nda në tri pjesë:

- “Stenta 1” – ku u gjykuan Agani dhe Shabani;
- “Stenta 2” – ku u akuzuan mbi 40 mjekë të spitaleve publike;
- “Stenta 3” – që përfshinte pronarët dhe mjekët e spitaleve private.

Edhe pse aktakuza ishte ngritur në 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktgjykim lirues vetëm më 1 gusht 2022, ndërsa Gjykata e Apelit e konfirmoi këtë vendim tek më 12 qershor 2023. Në total, procesi gjyqësor për këtë rast ka zgjatur 8 vite, dhe duke qenë se veprat e akuzuara ishin kryer midis 2011-2015, parashkrimi i plotë i ndjekjes penale do të ndodhë më 31 dhjetor 2025. Ky rast është dëshmi tjetër e mungesës së efikasitetit të institucioneve të drejtësisë në ndjekjen dhe gjykimin e korrupsionit.

Rasti “Toka” – Një proces i “pafund” gjyqësor

Ndër rastet më të gjata dhe të ndërlikuara të korrupsionit në Kosovë është rasti “Toka”, ku janë të akuzuar ish-deputeti i PDK-së, Azem Syla, dhe 45 persona të tjerë. Ata përballen me akuza për krim të organizuar, keqpërdorim të pozitës zyrtare, pastrim parash, marrje të mitos, mashtrim të rëndë dhe dëmtim të buxhetit të shtetit në vlerë prej 30 milionë euro. Për më tepër, pas zhvillimit të hetimeve, dhe kalimit të rastit nga EULEX-i në duar të organeve vendore – PSRK-së, ishte vendosur që për këtë rast të ngritën dy aktakuza, “Toka 1” – me 22 të akuzuar, në të cilën akuzohej ish-deputeti Syla; si dhe “Toka 2” – me 24 të akuzuar.

Aktakuza për këtë rast ishte ngritur në vitin 2016, por pas tetë vitesh proces gjyqësor gjykata e shkallës së parë arriti të nxjerr një vendim.⁴ Në vendimin e shpallur më 26 dhjetor 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi që Azem Sylën ta shpallë të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës, kurse ndaj 9 të akuzuarve të tjerë, vendosi

dënime me burgim prej 39 vitesh, dhe gjoba në total prej 220 mijë eurove.⁵ Pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor nisi në qershor 2019, tri vite pas seancës fillestare të vitit 2016, ritmi i gjykimeve ka qenë jashtëzakonisht i ngadaltë. Për shembull, në periudhën nëntor 2019 – shkurt 2020, për rastin “Toka 1” u mbajtën vetëm 8 seanca gjyqësore. Për më tepër, gjatë pandemisë COVID-19, në periudhën mes viteve 2020-2022, për shkak të ndërremeve të vazhdueshme të gjyqtarëve dhe masave kufizuese, nuk u mbajt asnjë seancë gjyqësore për gati dy vite.


Edhe pas rikthimit në normalitet nga pandemia, vonesat kanë vazhduar. Në vitin 2024, janë mbajtur vetëm 2 seanca gjyqësore, ndërsa 9 të tjera janë shtyrë. Kjo dëshmon se, në raste të tilla të mëdha dhe komplekse, zvarritjet e qëllimshme apo mungesa e kapaciteteve institucionale çojnë në dështimin e drejtësisë dhe minojnë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

3 Betimi për Drejtësi, Raport analitikë: Integriteti i Sistemit të Drejtësisë në Luftën kundër Korrupsionit në Kosovë (dhjetor 2018), faqe 30. I qashëm në linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/IKD-Raporti-SHQIP-FINAL.pdf>

4 Betimi për Drejtësi, Rasti Toka, 18 prill 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-shembull-i-deshimit-te-sistemit-te-drejtësisë-ne-luftën-kunder-korrupsionit-dhe-krimet-te-organizuar/> [qasur më 29 nëntor 2024].

5 Kallxo.Com, 26 dhjetor 2024, <https://kallxo.com/lajm/rasti-toka-gjykata-merr-vendim-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve/> [qasur më 14 mars 2025].







MANGËSITË E AKTAKUZAVE – FAKTORI KRITIK NË DËSHTIMIN E NDJEKJES SË RASTEVE TË KORRUPSIONIT

Një nga faktorët kryesorë që ka çuar në dështimin e rasteve të mëdha të korrupsionit në Kosovë është përgatitja jo adekuate e aktakuzave nga Prokuroria e Shtetit. Këto mangësi reflektojnë probleme sistemike në sistemin e drejtësisë dhe përfshijnë:

- **Kualifikimin e gabuar ose të pasaktë të veprave penale**, që shpesh ndryshohet gjatë fazave të ndryshme të procesit;
- **Mospërcaktimin e saktë të dëmit financiar** të shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit;

Rasti “Pronto” – Një aktakuzë e dështuar që ndryshoi disa herë

Rasti “Pronto” është një nga shembujt më të qartë të një aktakuze të dobët dhe të paqëndrueshme. Në këtë rast, ish-deputeti Adem Grabovci dhe tre persona të tjerë akuzoheshin fillimisht për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Më pas, gjatë fazës së hetimeve, akuza u ndryshua në ushtrim ndikimi, ndërsa në procesin gjyqësor kualifikimi penal ndryshoi sërish në një vepër më të lehtë – shkelje e statusit të barabartë të qytetarëve të Kosovës.⁶

- **Mungesën e provave dhe argumenteve të fuqishme ligjore**, që shpesh çojnë në lirimin e të akuzuarve.
- **Mungesën e propozimeve për konfiskimin e pasurisë**, duke lënë hapësirë që të ardhurat e përfituara nga korrupsioni të mbeten në duart e të akuzuarve.

Ky ndryshim i vazhdueshëm i veprës penale reflekton mungesën e një baze të fortë ligjore, duke bërë që rasti të ishte i destinuar për të dështuar. Aktakuza nuk përcaktonte qartë cilët ishin palët e dëmtuara dhe çfarë dëmi financiar ishte shkaktuar, dhe për këtë arsye, Gjykata shpalli të akuzuarit të pafajshëm për mungesë provash.

6 Telegrafi.Com <https://telegrafi.com/prokuroria-ngrit-aktakuze-ndaj-grabovcit-beqajt-pajazitit-dhe-te-tjeteve-lidhur-aferen-pronto/> [qasur më 1 dhjetor 2024].



Rasti i “Veteranëve të rremë” – Mungesa e provave për një skandal 88 milionë euro

Një tjetër shembull klasik i një aktakuze të dobët është rasti i “Veteranëve të rremë”, ku ish-kryeministri Agim Çeku dhe disa zyrtarë të tjerë u akuzuan për manipulimin e listave të veteranëve të UÇK-së,⁷ duke shkaktuar një dëm financiar prej 88 milionë eurosh ndaj buxhetit të shtetit.

Gjykata i shpalli të pandehurit të pafajshëm në shkallë të parë, pasi Prokuroria nuk arriti të sigurojë prova bindëse që të vërtetonin manipulimin me listat. Ky rast, për nga ndikimi financiar dhe politik, është një nga më të rëndësishmit në Kosovë, por mungesa e një aktakuze të ndërtuar mbi fakte të pakundërshtueshme e bëri të pamundur ndëshkimin e përgjegjësve.

Megjithatë, pas këtij vendimi të shkallës së parë, Prokuroria e Shtetit paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila pranoi ankesën në fjalë dhe anuloi vendimin e Themelores për

shpalljen e këtyre personave si të pafajshëm, duke kërkuar rigjykim në tërësi të rastit në fjalë.

Kjo ngase siç thuhet në vendimin e datës 22 prill 2022 të Apelit, gjatë procesit në shkallë të parë, pati shkelje procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Për më tepër, Gjykata e Apelit theksoi se duke vërejtur që si fakt vendimtar në aktgjykim është pretenduar nga prokuroria se bëhet fjalë për 19 mijë e 500 aplikacione të cilat ndërlidhen me kategorizimin e këtyre aplikuesve, nga shkresat e lëndës rrjedhë se këto aplikacione nuk janë administruar si provë, por janë administruar listat si tërësi në numër prej 19 mijë e 500.⁸ Rasti aktualisht, pas kthimit në rigjykim, po vazhdon me dëgjimin e dëshmitarëve dhe ende nuk ka vendim për këtë çështje.

Rasti “PTK” – Një aktakuzë tjetër e dështuar për shkak të mungesës së provave

Një rast tjetër ku Prokuroria dështoi të përgatisë një aktakuzë të qëndrueshme dhe kualitative është ai kundër Shyqeri Haxhës, ish-drejtorit të PTK-së.

Ai akuzohej për lidhjen e një kontrate të dëmshme për Postën e Kosovës, por për shkak të mangësive në aktakuzë, gjykata e cilësoi atë si të pabazuar në prova dhe e liroi nga akuza.

“VIZAT” – aktakuzat pa prova

Një problem i ngjashëm u pa edhe në rastin e Milaim Zekës, i cili akuzohej për mashtrimin e qytetarëve për pajisjen me viza të BE-së, por për shkak të dobësisë së aktakuzës, ai u lirua nga akuza.

Po ashtu, në rastin e mashtrimit me viza italiane, ku të akuzuar ishin Ukë Rugova (djali i ish-presidentit Ibrahim Rugova) dhe ish-ministri Astrit Haraqija, aktakuza ishte e dobët dhe e pambështetur në prova, duke çuar në lirimin e të pandehurve.

Rasti “53 milionëshi” – Problemi me përcaktimin e dëmit

Një tjetër problematikë e aktakuzave në Kosovë është mospërcaktimi i saktë i dëmit financiar të shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit. Ky problem u pa qartë në rastin e njohur si “53 milionëshi”, ku i akuzuar ishte ish-ministri Pal Lekaj

dhe tre zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Infrastrukturës për keqpërdorim të pozitës dhe detyrës zyrtare.

7 Koha.Net, shtator 2018, <https://www.koha.net/arberi/kush-jane-te-akuzuarit-ne-rastin-e-veteraneve-te-rrejshe> [qasur më 1 dhjetor 2024].

8 Nacionale.Com, <https://nacionale.com/drejtasi/me-ne-fund-me-16-dhjetor-nis-rigjykimi-ne-rastin-veteranet> [qasur më 14 mars 2025].





Fillimisht, Prokuroria pretendonte se dëmi i shkaktuar ishte 53 milionë euro, por pas një ekspertize të porositur nga gjykata, u vërtetua se shuma e saktë ishte 38 milionë euro.⁹

Përndryshe pas rreth tri viteve proces gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë në janar të vitit 2024, shpalli vendim dënues ndaj Ish-Ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj duke e dënuar me 3 vjet e tetë muaj burgim efektiv në lidhje me pagesën prej 53 milionë eurove që Qeveria e Kosovës i kishte paguar “Bechtel-Enkës” për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në autostradën ‘Arbën Xhaferi’.¹⁰

Pal Lekajt i ishte shqiptuar edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në administratë publike për 3 vite e gjashtë muaj. Gjithashtu, në këtë rast ishin të përfshirë edhe ish-sekretari i Ministrisë Nebih Shatri i cili u dënua me një vit e tetë muaj burgim, po ashtu, drejtori i Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës Besim Tahiri i cili u dënua me një vit e tetë muaj burgim si dhe ish-këshilltari i Pal Lekajt, Eset Berisha i cili u dënua me 3 vjet e tre muaj burgim.

Aktakuza për këtë rast u ngrit më 4 shkurt të vitit 2022, dhe këta persona i ngarkonte për veprën penale Keqpërdorim i Pozitës dhe Autoritetit Zyrtar.

Vlen të theksohet se përkundër vendimit dënues të shkallës së pare, Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesave të palës mbrojtëse në shkurt të vitit 2025, vendosi që këtë vendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ta anulojë dhe ta kthej rastin në tërësi në rigjykim.¹¹

Rasti “Thesari” – Një shembull i rrallë i një aktakuze të suksesshme

Në kontrast me shumicën e rasteve të dështuar, rasti “Thesari” është një nga të paktët rastet ku Prokuroria ka ndërtuar një aktakuzë të qëndrueshme dhe të mbështetur në prova.

Në këtë rast, Labinot Gruda dhe Kadri Shala u akuzuan për vjedhjen e 2 milionë eurove nga Thesari i Shtetit,¹² dhe aktakuza përfshinte a) Kualifikim të saktë të veprave penale (keqpërdorim i pozitës zyrtare, pastrim parash, hyrje e

Apeli theksoi që aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ka arsye mbi faktet vendimtare sa i përket rrethanave që kanë plotësuar kushtet mbi elementet që e përbëjnë figurën e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar për të cilën akuzoheshin këta katër persona. Kjo ngase nuk pati asnjë arsye të dhënë se cilat dispozita saktë të Ligjit të prokurimit publik janë shkelur që do të bënin tejkalim të kompetencave nga ana e të akuzuarve Pal Lekaj, Eset Berisha, Nebih Shatri dhe Besim Tahiri.

Për më tepër, Apeli me këtë vendim theksoi se Gjykata Themelore me vendimin dënues, nuk ka dhënë ndonjë arsye lidhur me faktet vendimtare kur ka konstatuar se në drejtim të realizimit të qëllimit të pandehurve Pal Lekaj dhe Eset Berisha kanë injoruar opinionin e kompanisë mbikëqyrëse “Hill International”, dhe se nuk ka sqaruar si duhet se opinion i tillë, a ishte këshillëdhënës për Ministrinë apo ishte detyrues.

Po ashtu, Apeli sqaroi edhe faktin që Gjykata e shkallës së pare nuk arsyetoi si duhet faktin se nga i lindi një bazë e tillë që kompania mbikëqyrëse ka pasur një kompetencë të tillë që si e vetme mund të jepte këshillën për lartësinë e kostos së demit financiar për shtyrjen e punimeve në autostradën Arbër Xhaferi.

Përndryshe nga ky vendim i Gjykatës së Apelit reflektohet qartë fakti së gjykimet e rasteve të mëdha të korrupsionit, manifestohet qartë mungesa e një hetimi dhe gjykimi të thelluar të çështjeve nga Prokuroria dhe Gjykata duke vënë në dyshim seriozitetin e trajtimit të këtyre lëndëve të korrupsionit.

paautorizuar në sistemet kompjuterike); b) Përcaktim të qartë të dëmit financiar; c) Sigurim të provave të forta, të cilat çuan në dënimin e të akuzuarve.

Ky rast tregon se, kur Prokuroria punon me profesionalizëm dhe mbështetet në prova të forta, është e mundur të arrihet dënimi i korrupsionit dhe konfiskimi i pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme.

9 Portali Kallxo.Com, 22 prill 2024 rasti 53 milionëshit, <https://kallxo.com/lajm/53-milioneshi-marreveshja-kunderligjore/> [qasur më 27 nëntor 2024].

10 Portali Gazeta Express, 31 janar 2024, <https://www.gazetaexpress.com/pal-lekaj-denohet-me-3-vjet-e-tete-muaj-burg-per-53-milioneshin/> [qasur me 14 mars 2025].

11 Portali Kallxo.Com 27 shkurt 2025, <https://kallxo.com/lajm/gjetjet-e-gjykes-se-apelit-lidhur-me-prishjen-e-vendimit-denes-te-gjykes-se-prishtines-ne-rastin-e-pal-lekajt-dhe-te-tjereve/> [qasur më 14 mars 2025].

12 Portali Kallxo.Com, 22 qershor 2023, <https://kallxo.com/lajm/afere-e-2-milioneshit-apeli-verteton-aktgjykimin-denes/> [qasur më 27 nëntor 2024].





POLITIKA E BUTË NDËSHKIMORE DHE MOS-EFIKASITETI NË KONFISKIMIN PENAL TË PASURISË NË RASTET E KORRUPSIONIT

Politika e butë ndëshkimore

Kosova vazhdon të përballet me mungesë efikasiteti në ndëshkimin e korrupsionit, veçanërisht kur bëhet fjalë për zyrtarët e lartë shtetërorë. Në shumicën e rasteve të profilit të lartë, proceset gjyqësore përfundojnë ose me aktgjykime liruese, ose në ato pak raste ku ka dënime në shkallë të parë, ato shpesh rrëzohen nga Gjykata e Apelit.¹³ Kjo tendencë ka krijuar një politikë të butë ndëshkimore, e cila jo vetëm që dekurajon luftën kundër korrupsionit, por edhe rrit perceptimin publik se zyrtarët e lartë janë të paprekshëm nga ligji.

Sipas Kodit Penal të Kosovës, për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ku dëmi financiar i shkaktuar buxhetit të shtetit është mbi 5,000 euro, parashikohet dënim me 6 muaj deri në 10 vite burg. Megjithatë, në praktikë, dënimet e shqiptuara kanë qenë shumë më të lehta se maksimumi i parashikuar nga ligji, duke krijuar një mospërputhje të thellë midis pasojave të korrupsionit dhe ndëshkimit të autorëve.

¹³ Instituti Democrit i Kosovës, analizë: "Kultura e pandëshkueshmërisë në Kosovë", publikuar në dhjetor 2020. I qasur në linkun: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2021/03/01-KULTURA-E-PAND%C3%8BSHKUESHM%C3%8BRIS%C3%8B-N%C3%8B-KOSOV%C3%8B-ALB-04.pdf>.



Dënime të buta edhe për dëme milionëshe

Duke analizuar rastet kryesore të korrupsionit, bëhet e qartë se edhe në rastet kur ka pasur dënime, gjykatat kanë qenë jashtëzakonisht të buta në vendimmarrje.¹⁴

Rasti "53 milionëshi":

Edhe pse dëmi i shkaktuar buxhetit të shtetit u vlerësua në 38 milionë euro, dënimi i shqiptuar ishte vetëm 3 vjet burg, një masë ndëshkuese shumë e ulët në raport me dëmin e shkaktuar.

Ndërkohë, shumë raste të tjera të mëdha të korrupsionit, si "Hidrocentralet", "Pronto", "Veteranët e rremë", "Vizat", "Stenta", rasti ndaj ish-ministrit **Nenad Rikallo**, rasti ndaj ish-deputetit **Milaim Zeka**, e të tjera – të gjitha përfunduan me vendime liruese, duke dëshmuar mungesën e një politike ndëshkimore të ashpër dhe efektive.


Një faktor që ndikon në këtë qasje të butë është mungesa e një praktike konsistente të ndëshkimit të korrupsionit në Kosovë, duke bërë që gjyqtarët të mos ndihen të obliguar për të shqiptuar dënime më të ashpra për zyrtarët e akuzuar për korrupsion të nivelit të lartë.

Rasti "Thesari" – Një përjashtim i rrallë

Një nga rastet e rralla ku drejtësia ka funksionuar në mënyrë të ashpër dhe efektive është rasti "Thesari", ku u vërtetua vjedhja e 2 milionë eurove nga buxheti i shtetit.

Në këtë rast, Gjykata Themelore në Prishtinë shqiptoi dënime të rënda. Fillimisht, Labinot Gruda dhe Kadri Shala u dënuan me 21 vite burg në total dhe 41,500 euro gjobë, si dhe gjykata urdhëroi kthimin e mjeteve të vjedhura në

buxhetin e shtetit. Për më tepër, vendimi u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duke krijuar një precedent pozitiv për trajtimin e rasteve të tilla.



¹⁴ Instituti i Kosovës për Drejtësi, qershor 2020, <https://kli-ks.org/ikd-politika-e-ndjekjes-dhe-denimeve-ndaj-profilite-te-larte-te-korrupsionit-pa-rezultate-konkrete-sistemi-i-drejtise-po-lufton-per-statistika-e-jo-korrupsionin/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

Mos-efikasiteti në konfiskimin penal të pasurisë në rastet e korrupsionit

Një nga problemet më të mëdha të sistemit të drejtësisë në Kosovë është mospërputhja e madhe mes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Sipas të dhënave nga Prokuroria e Shtetit për vitin 2023, **87,847,347** euro pasuri u sekuestruan në mënyrë të përkohshme; ndërsa vetëm **23,594,635** euro u konfiskuan përfundimisht me vendim gjyqësor.¹⁵ Kjo do të thotë se vetëm 26.8% e pasurive të sekuestruara përfundimisht konfiskohen, duke reflektuar mos-efikasitetin e sistemit në finalizimin e këtyre proceseve.

Gjithashtu, një raport i publikuar nga organizatat e shoqërisë civile në vitin 2023 theksonte se nga 20 aktakuza të ngritura për korrupsion gjatë vitit 2023, vetëm në 4 raste kishte propozime për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë, ndërsa në 16 raste nuk kishte propozime fare.¹⁶ Kjo do të thotë se vetëm 20% e rasteve të korrupsionit përfshinin kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë, ndërsa në 80% të rasteve, prokuroria nuk kishte kërkuar fare konfiskimin e pasurisë së përfituar nga korrupsioni.

Kjo tregon qartë se Prokuroria e Shtetit nuk i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme luftës kundër korrupsionit përmes mekanizmit të konfiskimit penal.

Raportet e BE-SË për Kosovën

Raportet e Bashkimit Evropian (Komisionit Evropian, specifikisht) për Kosovën, theksojnë në vazhdimësi se Kosova ka nevojë për përmirësim të ndjeshëm në hetimet e korrupsionit, vendimet gjyqësore përfundimtare dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.¹⁷ Gjithashtu, këto raporte vlerësojnë që proceset gjyqësore zgjasin shumë, duke e bërë konfiskimin e pasurisë një proces të gjatë dhe shpesh të pasuksesshëm.

Kësisoj, mungesa e konfiskimeve dhe politika e butë ndëshkimore e bëjnë luftën kundër korrupsionit joefektive. Edhe kur ka aktgjykime dënimi, mungesa e konfiskimeve lejon që të akuzuarit të mbajnë përfitimet e paligjshme, duke e kthyer korrupsionin në një krim me rrezik të ulët dhe fitime të larta.

15 Të dhënat e mbledhura nga raporti zyrtar i punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës i publikuar në vitin 2023. Raporti i qasshëm në linkun: <https://prokuroria-rks.org/wp-content/uploads/2024/06/Raporti-Vjetor-i-Punes-se-KPK-se-per-vitin-2023.pdf>

16 Portali Koha.Net, nëntor 2019 <https://www.koha.net/arberi/ikd-mbetet-sfide-konfiskimi-i-pasurise-se-paligjshme> [qasur më 27 nëntor 2024].

17 Portali Radio Evropa e Lirë, tetor 2024, <https://www.evropaelire.org/a/ke-vlereson-perparimin-e-kosoves-raporti-progresit-/33179801.html> [qasur më 29 nëntor 2024].





TRAJTIMI INSTITUCIONAL I RASTEVE TË KORRUPSIONIT GJATË VITIT 2024

Gjatë vitit 2024, ndjekja penale dhe proceset gjyqësore të rasteve të korrupsionit në Kosovë kanë vazhduar me intensitet të ndryshëm. Gjatë kësaj periudhe, një numër i konsiderueshëm rastesh janë nën hetim, ndërsa disa aktakuza të ngritura nga Prokuroria Speciale kanë hyrë në fazën e gjykimit.

Qeverisja e Lëvizjes Vetëvendosje është deklaruar vazhdimisht për angazhim drejt forcimit të sistemit të drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit.

Rasti “Martin Berishaj”

Një nga rastet më të diskutuara në vitet e fundit është rasti i ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, i cili është nën hetim për shpëlarje parash, shmangie nga tatimi dhe deklarim të rremë të pasurisë.

Si nisi ‘skandali’?

Në prill 2022, Nacionale publikoi një raport mbi përfshirjen e Berishajt në një skandal të madh financiar në Slloveni.¹⁸

18 Portali Nacionale, <https://nacionale.com/drejttesi/ekzkluзивe-pas-raportimit-te-nacionales-prokuroria-nis-hetimet-ndaj-martin-berishajt> [qasur më 2 dhjetor 2024].

19 Portali Telegrafi.com, <https://telegrafi.com/en/martin-berishaj-says-that-he-has-sued-the-slovenian-media-that-claimed-to-have-discovered-his-scandal/> [qasur më 3 dhjetor 2024].



Pagesat në llogarinë e kompanisë së Berishajt dyshohet se ishin bërë nga një kompani serbe, me transferta nga 5,000 deri në 50,000 euro në muaj.

Prokuroria e Kosovës nisi hetimet në shtator 2022,²⁰ por dy vite më vonë, ende nuk ka asnjë aktakuzë të ngritur.

Në prill 2024, Prokuroria Speciale intervistoi Berishajn dhe konfirmoi se hetimet vazhdojnë,²¹ por pa ndonjë progres të dukshëm. Ky rast, për shkak të ndjeshmërisë politike dhe karakterit ndër-kufitar, mbetet një test për efikasitetin e institucioneve të drejtësisë në Kosovë.

Rasti “Rezervat Shtetërore”

Ky është një nga rastet më të mëdha të korrupsionit në nivel institucional, që përfshin zyrtarë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe një biznesmen të njohur.

Më 18 gusht 2023, Prokuroria Speciale bastisi Ministrinë e Industrisë dhe pronat e biznesmenit Ridvan Muharremi, duke arrestuar dy zyrtarë të ministrisë, Hafiz Gara dhe Leutrim Lipovica, si dhe biznesmenin Muharremi.²²

Zyrtarët e arrestuar dyshohen për Keqpërdorim të detyrës zyrtare; Manipulim të procedurave të prokurimit për blerjen e rezervave shtetërore; si dhe Moskryerje të procedurave të hapura të tenderimit, duke klasifikuar kontratat si “sekrete”.²³

Rasti aktualisht është në fazën e hetimeve, me pritje për ngritjen e një aktakuze nga Prokuroria Speciale. Vlen të theksohet se gjatë kësaj faze të hetimeve nga ana e Prokurorisë, është ftuar në cilësinë e dëshmitarit edhe kryeministri i tanishëm i Kosovës, Albin Kurti, i cili përkundër tri ftesave të prokurorisë për t’u paraqitur dhe ofruan dëshminë e tij, si dhe përkundër edhe të një urdhri gjyqësor të lëshuar nga Gjykata në Prishtinë, i njëjti ka refuzuar të japë dëshminë e tij në ambientet e Prokurorisë, duke kushtëzuar madje Prokurorinë që kjo dëshmi të jepet në zyrat e tij dhe në oraret që i njëjtin i përcakton paraprakisht prokurorisë së shtetit.²⁴

Një veprim i tillë, padyshim e vë në pikëpyetje respektimin e sundimit të ligjit në Kosovë, e madje, cenon rëndë edhe parimin e barazisë së të gjithëve para ligjit, parim ky që vlen ndaj të gjithë qytetarëve pavarësisht pozicionit që mban.

20 Portali Kallxo.Com, Shtator 2022, <https://kallxo.com/lajm/prokuroria-e-prishtines-fillon-hetimet-ndaj-ambasadorit-berishaj/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

21 Portali Demokracia.Com, mars 2024, <https://demokracia.com/prokuroria-speciale-martin-berishaj-eshte-intervistuar-me-dyshimet-per-veprat-penale-shpelarja-e-parave-shmangia-nga-tatimi-dh/> [qasur më 3 dhjetor 2024].

22 Portali Betimi për Drejtësi, Gusht 2024, <https://betimiperdrejtesi.com/tre-te-arrestuar-per-dallavere-me-rezerva-shteterore-ne-pranga-edhe-ridvan-muharremi/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

23 Portali Albanian Post, 6 gusht 2024, <https://albanianpost.com/irfan-lipovica-i-arrestuari-per-skandalin-me-grure-vaj-e-sheqer-i-perzgjedhur-per-tu-emeluar-kryeshef-ne-drejtorene-e-akreditimit-te-kosoves/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

24 Portali Telegrafi.Com, janar 2025, <https://telegrafi.com/kurti-tregon-pse-po-refuzon-te-shkoje-ne-prokurorine-speciale/> [qasur më 14 mars 2025].





Rasti “Nagip Krasniqi – KEK”

Një tjetër rast i rëndësishëm i trajtuar gjatë vitit 2024 është rasti i ish-kryeshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqi, i cili akuzohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe shmangie tatimore.

Dëmi i shkaktuar buxhetit të Kosovës nga veprimet e tij dyshohet se arrin në mbi 3.2 milionë euro, përveç 500 mijë eurove të shmangies tatimore.²⁵

Krasniqi dyshohet se, gjatë periudhës 2021–2023, ka ndihmuar kompaninë slovene Holding Slovenske Elektrane SE të marrë kontrata për tregtimin e energjisë elektrike në kundërshtim me ligjet për energjinë në Kosovë.

Sipas prokurorisë, Nagip Krasniqi, me dashje ka aprovuar blerjet, ka nënshkruar kontrata dhe ka autorizuar nënshkrimin e tyre si dhe ka konfirmuar vazhdimin e tregtimit me operatorin në fjalë, ani pse ishte në dijeni se nuk mund të tregtohej energji elektrike me këtë operator derisa ai nuk licencohej apo nuk i njihej licenca nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE).

Procesi gjyqësor filloi në shtator 2024, dhe në seancën e parë, Krasniqi u deklarua i pafajshëm.²⁶

Rasti “DONIKA GËRVALLA”

Një nga rastet më të debatuar në vitin 2024 është rasti i ministres së Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, e cila u akuzua për mosraportim të saktë të pasurisë.

Fillimisht, për këtë rast në medie ishte raportuar se Donika Gërvalla, zëvendëskryeministre dhe ministre e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), nuk ka deklaruar të gjitha funksionet në institucione vendore e ndërkombëtare. Katër muaj pas këtyre publikimeve Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kishte njoftuar se është ende duke trajtuar rastin e ministres Gërvalla.

Sipas këtyre publikimeve rezultoi se ministrja Gërvalla nuk kishte deklaruar se posedon biznes në Gjermani, nuk ka treguar se është drejtoreshë e një fondacioni në Kosovë dhe as nuk ka deklaruar pasurinë e burrit dhe fëmijëve të saj.

Në janar 2023, Prokuroria ngriti aktakuzë ndaj saj për deklarim të rremë të pasurisë, pasi ajo nuk kishte deklaruar një biznes në Gjermani dhe disa funksione publike e private.²⁷ Gërvalla fillimisht mohoi akuzat, duke argumentuar se bëhej fjalë për një gabim

administrativ dhe jo një vepër penale.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 qershor 2024, e konfirmoi aktakuzën dhe refuzoi kërkesën për hudhjen e saj.²⁸ Gjykata e Apelit, më vonë, miratoi këtë vendim, duke e çuar çështjen drejt gjykimit.²⁹ Që nga seanca fillestare, e mbajtur më 7 mars 2024, një seancë ishte tentuar të mbahej më 7 nëntor 2024 por kishte dështuar për shkak të mungesës së zonjës Gërvalla.

Elementi më i diskutueshëm i këtij rasti është mënyra se si u zhvillua procesi gjyqësor. Më 19 nëntor 2024, brenda një dite të vetme, gjykata zhvilloi të gjitha fazat e shqyrtimit gjyqësor³⁰ dhe shpalli vendimin përfundimtar, duke e liruar Gërvallën për mungesë provash.

Arsyetimi i gjykatës ishte se vepra e saj përbënte një shkelje administrative (kundërvajtje), dhe jo një vepër penale.³¹

Ky vendim ngriti pikëpyetje mbi qasjen selektive të gjykatave në trajtimin e zyrtarëve të lartë shtetërorë, duke e bërë këtë një rast me ndikim të madh politik dhe publik.

25 Portali Telegrafi.Com, Shtator 2024, <https://telegrafi.com/dosja-e-nagip-krasniqit-mbi-3-2-milione-euro-dem-per-kek-un-e-mbi-500-mije-euro-shmangie-nga-tatimi/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

26 Portali Paparaci.Com, 19 shtator 2024, <https://paparaci.com/452640/nis-gjykimi-ndaj-nagip-krasniqit/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

27 Portali Nacionale.com, <https://nacionale.com/politike/prokuroria-ngre-aktakuze-ndaj-donika-gervalles> [qasur më 2 dhjetor 2024].

28 Portali Klan Kosova, 19 gusht 2024, <https://klankosova.tv/konfirmohet-aktakuza-ndaj-ministres-gervalla-per-mosdeklarim-te-pasurise/> [qasur më 3 dhjetor 2024].

29 Portali Telegrafi.Com, tetor 2024, <https://telegrafi.com/apeli-refuzon-kerkesen-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ministres-gervalla-per-mosdeklarim-te-pasurise/> [qasur më 2 dhjetor 2024].

30 Portali Betimi për Drejtësi, 19 nëntor 2024, <https://betimiperdrejtesi.com/ministrja-gervalla-lirohet-nga-akuza-per-mosraportim-te-pasurise/> [qasur më 3 dhjetor 2024].

31 Portali Nacionale.Com 19 nëntor 2024, <https://nacionale.com/drejtesi/gjykata-e-liron-donika-gervallen-nga-akuzat-per-raportim-te-rrejshem-te-pasurise/> [qasur më 3 dhjetor 2024].





PËRFUNDIME

Kjo analizë ka trajtuar në mënyrë të hollësishme mënyrën se si sistemi gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë ka menaxhuar dhe trajtuar rastet e korrupsionit, sidomos viteve të fundit. Duke përmbledhur të dhëna, monitoruar procese dhe analizuar rastet kryesore, punimi synon të shërbejë si një mjet për hartimin e politikave më të mira, promovimin e transparencës, përmirësimin e hetimeve dhe edukimin e qytetarëve mbi ndikimin dhe pasojat e korrupsionit. Në këtë mënyrë, kontribuon në rritjen e llogaridhënies institucionale dhe fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Fokusi kryesor i kësaj analize ka qenë monitorimi, identifikimi dhe grumbullimi i të dhënave mbi trajtimin e rasteve të korrupsionit nga sistemi gjyqësor në Kosovë.

Analiza ka nxjerrë në pah mangësitë dhe dobësitë në politikat ekzistuese të ndjekjes dhe administrimit të drejtësisë për rastet e korrupsionit, duke identifikuar tri problemet kryesore që ndikojnë negativisht në luftën kundër korrupsionit në Kosovë:

- **Zvarritja e proceseve gjyqësore**, që shpesh çon në parashkrimin e lëndëve dhe lirimin e të akuzuarve, pavarësisht dëmit financiar të shkaktuar.
- **Mangësitë thelbësore të aktakuzave**, të cilat karakterizohen nga kualifikimi i pasaktë i veprave penale, mungesa e provave të forta dhe mos-saktësimi i dëmit të shkaktuar, duke krijuar hapësira për lirimin e të pandehurve.
- **Politika e butë ndëshkimore**, ku edhe në rastet kur ka dënime, ato janë minimale në raport me dëmin e shkaktuar, ndërsa në shumicën e rasteve të mëdha aktgjykimet janë liruese ose rrëzohen nga Gjykata e Apelit.

Një tjetër sfidë madhore është **mungesa e konfiskimeve penale të pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme**. Të dhënat tregojnë se, pavarësisht sekuestrimeve të përkohshme të pasurisë, shumica e aseteve të përfituara nga korrupsioni nuk konfiskohen përfundimisht, duke lënë krimin ekonomik pa pasoja reale dhe duke minuar përpjekjet për rikuperimin e dëmeve të shkaktuara buxhetit të shtetit.

Rëndësia e publikimit të databazës dhe transparenca në qeverisje

Kjo analizë, si dhe databaza e rasteve të korrupsionit, synon të luajë një rol kyç në rritjen e transparencës dhe mbikëqyrjes publike mbi institucionet. Me akses të hapur në informacion, qytetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë

civile mund të monitorojnë nga afër rastet e korrupsionit dhe të kërkojnë më shumë llogaridhënie nga institucionet përkatëse.



RAPORTO KORRUPSIONIN

THIRR

**0800
77 777**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI-së, ju lutem vizitoni: www.kdi-kosova.org



Funded by
the European Union

ose online në linkun
<https://raporto.kdi-kosova.org/>

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**